



DSIK

DEKLASIFIKUAR PJESËRISHT

ME VENDIM TË KDZH
Nr. 863, datë 18/3/2021

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KRYEMINISTRIA
DREJTORIA E SIGURIMIT TË INFORMACIONIT TË KLASIFIKUAR

Nr. 2357 Prot.

“Sekret”
Afati i ruajtjes së klasifikimit 10 vjet
Kopje Nr. 19/31
Tiranë, më 19/3/2021

Lënda: Dërgohet raporti mbi Kontrollin e Figurës për subjektin e rivlerësimit Ken Vasil Dhima.

Drejtuar: KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT

TIRANË

Në zbatim të kërkesave të nenit 39, pika 2, të Ligjit nr. 84/2016 “Për Rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe kërkesës Tuaj Nr. 4427 Prot, datë 30.06.2020 për përditësimin e informacioneve të ardhura nga autoritetet verifikuese për subjektin e rivlerësimit, pas afatit ligjor të përfundimit të procedurave të kryera nga Grupi i Punës për Kontrollin e Figurës të z. Ken Vasil Dhima, me detyrë gjyqtar pranë Gjykatës Administrative, Vlorë, Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) ju informon se:

- Me Shkresën Nr. 12211 Prot, datë 02.11.2017 është përcjellë në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit raporti për Kontrollin e Figurës për subjektin e rivlerësimit Ken Vasil Dhima me konstatimin për papërshtatshmëri në vazhdimin e detyrës nga ky subjekt rivlerësimi

Informacionet e ardhura nga autoritetet verifikuese në kohështrirje gjatë periudhës së rivlerësimit na bëjnë me dije se:

- Për subjektin e rivlerësimit Ken Dhima disponohen të dhëna dhe [redacted] të viteve 2015, 2017, 2018 dhe 2020, [redacted] mbi përfshirjen e tij në veprimtari të kundërligjshme shfaqur në formën e shpërdorimit të detyrës dhe ndërveprimit korruptiv [redacted]
- Institucionet verifikuese për subjektin e rivlerësimit Ken Dhima kanë ndarë informacion me Prokurorinë e Përgjithshme (PP), Prokurorinë për Krimet e Rënda (PKR), PRRGJ Fier [redacted], konkretisht:

tj
i
is
s

kanurejt per juimit te paugjshem.

• [REDACTED] ku ndër të tjera thuhet se : "... pjesë e një grupi kontrolli të KLD-së, për inspektimin e gjyqtarit të Gjykatës Administrative, Vlorë, Ken Dhima, para zhvillimit të kontrollit, [REDACTED] 2018, i ka sugjeruar atij qëndrimet që duhet të mbajë për justifikimin e mangësive dhe problematikave të konstatuara në raport me objektin e kontrollit.

• [REDACTED]

• [REDACTED] ku ndër të tjera thuhet se:
ngrihen dyshime për përfshirje të mundshme në veprimtari të kundërligjshme të shtetasit Ken Dhima, me detyrë gjyqtar në Gjykatën Administrative, Vlorë, shfaqur në formën e shpërdorimit të detyrës gjatë dhënies së një vendimi për një çështje civile në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Vlorë, si dhe të ushtrimit të ndikimit të paligjshëm ndaj një gjyqtar në Gjykatën e Shkallës së Parë, Fier, me qëllim mbylljen e procesit gjyqësor, pas kallesimit penal në ndikim të vetë subjektit të rivlerësimit Ken Dhima nga një gjyqtar në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Vlorë...."

• [REDACTED] ku ndër të tjera thuhet se:
se shtetasi Ken Dhima, me detyrë gjyqtar në Gjykatën Administrative, Vlorë, është përfshirë në veprimtarinë e kundërligjshme, shfaqur në formën e shpërdorimit të detyrës dhe ndërveprimet korruptive, ushtrimit të ndikimit të paligjshëm,

Për subjektin e rivlerësimit Ken Dhima sygjerojmë të merren parasysh elementët që evidentojnë përfshirjen e tij në veprimtari korruptive, pasi në frymën kundër korupsion të ligjit 84/2016, vlerësohet se integriteti profesional është përcaktues për pastërtinë e figurës së subjekteve të rivlerësimit.

Sa sipër:

- a. Të dhënat/informacionet që disponohen për subjektin e rivlerësimit, vlerësohen për aktualitetin e tyre, kohëzgjatjen, në më shumë se një herë, të përfshirjes apo implikimit në veprimtari të kundërligjshme, në formën e korrupsionit pasiv të gjyqtarit, në papajtueshmëri të plotë me ushtrimin e detyrës së tij funksionale.
- b. Duhet vlerësuar fakti që për subjektin e rivlerësimit autoritetet verifikuese kanë informuar instancat përkatëse për trajtimin dhe shqyrtimin e rasteve të dyshuara të abuzimit me detyrën, apo përfshirjen në marrëdhënie korruptive të funksionarëve të sistemit të drejtësisë.
- c. Bazuar në Nenin 38, të ligjit 84/2016, ligjvënësi i është referuar kontakteve të papërshtatshme, që mund të ketë subjekti i rivlerësimit me persona të përfshirë në krimin e organizuar Nisur nga qëllimi dhe fryma e ligjit, ku procesi i rivlerësimit përfshin kontrollin tërësor të prokurorëve dhe gjyqtarëve duke filluar nga vetë subjekti e më pas duke zbuluar ose identifikuar lidhjet e subjekteve me krimin e organizuar, më së pari subjekti i rivlerësimit është vetë subjekti i kontrollit të ligjit dhe i përfshirjes ose jo në krimin e organizuar.
- d. Mbi bazën e informacioneve që disponohen për subjektin e rivlerësimit Ken Vasil Dhima, në cilësinë e gjyqtarit pranë Gjykatës Administrative, Vlorë, për raste të mundshme të premtimit apo kërkimit të drejtpërdrejtë apo të tërthorazi, të çfarëdolloj përfitimi të parregullt, për të kryer ose mos kryer një veprim, që lidhet me detyrën e tij funksionale, gjatë fazës së gjykimit të disa çështjeve penale, marrëdhënia korruptive e vendosur mes tij dhe palës tjetër, që mund të jetë personi në gjykim apo një "person tjetër i lidhur", është një marrëdhënie apo kontakt i papërshtatshëm, në papajtueshmëri të plotë me detyrën e tij funksionale.
- e. Marrëdhënia e dyshuar korruptive ndërmjetësohet dhe shtrihet në persona të tretë (palët në gjykim), lidhje pune të subjektit të rivlerësimit, duke vendosur sipas përcaktimit të pikës 6, të nenit 3, të ligjit nr. 84/2016, një "kontakt të papërshtatshëm", në papajtueshmëri të plotë me ushtrimin e detyrës nga ky subjekt rivlerësimi.
- f. Për informacionet e ardhura nga institucionet verifikuese
- g. Z. Ken Dhima oseidon edhe në ora ortë Greke
Referuar parashikimeve të bëra në Aneksin e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, "Rivlerësimi kalimtar i gjyqtarëve dhe prokurorëve", në nenin DH "Kontrolli i figurës", pika 4, subjekti i rivlerësimit Ken Dhima ka bërë deklaram të pasaktë në plotësimin e deklaratës për kontrollin e figurës, konkretisht në faqen 2, "Të dhëna identifikuese" pyetja "A keni pasur shtetësi tjetër ose dyshtetësi" Mosdeklarimi në këtë rast, e ngarkon me përgjegjësinë e fshehjes së faktit dhe me plotësimin jo me vërtetësi të Deklaratës për Kontrollin e Figurës.
- h. Raporti i Grupit të Punës me Nr. 11897, datë 31.11.2017 për kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit Klorinda Shyqyri Çela (bashkëshortja e Ken Dhima), ku për

SEKRET

gjqtarene Çela ka informacione për implikim në veprimtari korruptive të funksionarit të drejtësisë, është shprehur për papërshtatshmëri në vazhdimin e detyrës nga ky subjekt rivlerësimi.

- i. Në përfundim arsyetojmë se, veprimtaria korruptive e subjektit të rivlerësimit, në bashkëpunim, cënon drejtpërsëdrejti pastërtinë e figurës, çfarë përmbush plotësisht përcaktimet e germave "b" dhe "c" të nenit 37, të ligjit 84/2016, ku Ken Dhima, vlerësohet si individ i mundshëm për t'u vënë nën presion nga strukturat kriminale.

Grupi i Punës nisur nga informacionet e siguruar nga autoritetet verifikuese, nuk ndryshon konstatimin fillestar të dhënë për subjektin e rivlerësimit, për papërshtatshmëri në vazhdimin e detyrës.

Ju faleminderit për mirëkuptimin.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Dorian TOLA



[Handwritten signature]